

PROCESVERBAL
nga seanca e 32-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 9.10.2023

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, L Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi profesional: Maja Damevska, mr. Emilija Janevska, mr. Ivona Mufisheva, mr. Arben Saiti, mr. Aleksandar Xhuvareviq, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë : /

Z. Petrushevski hapi seancën e 32-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 14:05 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave në katin e 2-të.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota "pro", miratoi:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 31-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 27.9.2023.
2. Propozim-vendim për dhënien e lejes për transmetim televiziv nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon burim të kufizuar në nivel rajonal.
3. Propozim për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip.
4. Propozim-vendim për vazhdimin e afatit për fillimin e kryerjes së veprimtarisë të Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës UNIVERZUM Shkup.
5. Propozim për ngritjen e procedurës për kundërvajtje kundër Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive METROPOLIS RADIO SHPK Shkup për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Media.
6. Propozim për ngritjen e procedurës për kundërvajtje kundër Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive METROPOLIS RADIO SHPK Shkup për shkelje të nenit 54 paragrafi (5) nga LSHMAAV.
7. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR TELEVISION PLUS SHPKNJP Kumanovë, për shkelje të nenit 51 paragrafi (1) nga LSHMAAV.
8. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR TV ZDRAVKIN Angelçe Zdravkin, SHPKNJP Veles, për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Media.

9. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR G-TV TELEVISION SHPKNJP Gostivar, për shkelje të nenit 14 të Ligjit për Media.
10. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR G-TV TELEVISION SHPKNJP Gostivar, për shkelje të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) nga LSHMAAV.
11. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik për lëndën e radhës të furnizimit publik - shërbim: Transmetim i të dhënave nga lokacione të largëta.
12. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe miratoi njëzëri Procesverbalin e propozuar të seancës së 31-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, të mbajtur më 27.9. 2023, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Z. Trajçevski e shpjegoi Propozim-vendimin për dhënien e lejes për transmetim televiziv nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon resurs të kufizuar në nivel rajonal. Ai shpjegoi se transmetuesi në fjalë funksionon si medium për një kohë të gjatë dhe deri më tani ka përdorur platformën e operatorit A1 nëpërmjet multipleks dixhital tokësor. Por për shkak të vështirësive financiare, ai filloi procedurën për marrjen e lejes së re në nivel rajonal, në të njëjtin rajon të Kavadarit, duke transmetuar program nëpërmjet një rrjeti publik të komunikimit elektronik që nuk përdor burim të kufizuar. Meqenëse i plotëson kushtet e përcaktuara nga LSHMAAV, sugjerohet që Këshilli të pranojë propozimin për dhënien e lejes për transmetim televiziv.

Z. Petrushevski sqaroi se SHTR K-TV është televizion nga Kavadari dhe është e qartë se kriza financiare i detyron transmetuesit të veprojnë kështu. Ai deklaroi se do ta mbështesë propozimin dhe se për të më e rëndësishmja është që media të mbijetojë, të vazhdojë të punojë sepse në radhë të parë bëhet fjalë për medium të vogël rajonal.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Vendim për dhënien e lejes për transmetim televiziv, shërbimit programor me format të përgjithshëm kryesisht argëtues, në gjuhën maqedonase, në nivel rajonal, zona e shpërndarjes D1 Crn Vrv - zonë në nivel rajonal Veles (komunat e Velesit, Çashkës, Sveti Nikollë, Lozovë, Gradsko, Rosoman, Negotinë dhe një pjesë të komunës së Kavadarit), subjektit juridik Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KTV Kavadar, me tekstin e propozuar në Vendim.

Shërbimi i programeve televizive do të transmetohet përmes rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon resurs të kufizuar.

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive detyrohet të fillojë me kryerjen e veprimtarisë menjëherë pas dhënies së lejes për transmetim televiziv nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk përdor resurs të kufizuar.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit të publikojë vendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

Z. Petrushevski pas votimit tha se shpreson që kushtet e punës për këtë transmetues dhe për të tjerët në të ardhmen të përmirësohen në aspektin financiar.

Pika 3

Udhëheqësja e Sektorit për Çështje Programore, mr. Emilija Janevska, shpjegoi Propozimin për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip. Ajo ka shpjeguar se propozimi është dhënë në bazë të mbikëqyrjes së jashtëzakonshme të kryer sipas detyrës zyrtare dhe në lidhje me pretendimet që janë bërë për transmetuesin në seancën publike që është mbajtur në ambientet e Agjencisë më 22 gusht të këtij viti. Pretendimet ishin se transmetuesi në rajone të ndryshme transmeton program të ndryshëm. Ajo shpjegoi se Sektori për Çështje Programore e ka kryer mbikëqyrjen më 6 shtator, me një analizë krahasuese të strukturës së programit të transmetuar të radiodifuzerit në dy frekuenca nga rrjeti i frekuencave që i shfrytëzon RA Kanal 77 për të mbuluar zonën në gjithë territorin. Frekuenca e parë 89,70 Mhz nga Vodno vrv e regjistruar në ambientet e Agjencisë dhe frekuenca 101,90 Mhz nga Popova Shapka e regjistruar në Gostivar. Mbikëqyrja ka konstatuar se ka dallime në strukturën e shërbimit programor që RA Kanal 77 transmeton në zonën e Shkupit dhe në zonën e Gostivarit, që është në kundërshtim me nenin 68 të LSHMAAV sepse radioja ka marrë vetëm një leje për transmetimin e shërbimit programor në radio në nivel shtetëror që do të thotë se i njëjti shërbim programor duhet të transmetohet përmes të gjitha frekuencave që i shfrytëzon për të mbuluar të gjithë zonën e shtetit. Lidhur me atë se në çfarë konsistojnë dallimet, ajo ka shpjeguar se ato janë koncentruar kryesisht në periudhat kur transmetohen blloqet e reklamave, respektivisht ka pasur kohëzgjatje të ndryshme të blloqeve të reklamave që në të njëjtën kohë transmetohen në Shkup dhe në Gostivar. Koha që kaloi deri në përfundimin e bllokut më të gjatë reklamues ishte e mbushur me muzikë. Kishte gjithashtu ndryshim dhe në përmbajtjen e blloqeve të reklamave dhe gjithashtu kohëzgjatje të ndryshme të reklamave. Për shembull, shërbimi në Gostivar ka transmetuar version më të shkurtër të një reklame, ndërsa shërbimi në Shkup ka transmetuar version më të gjatë të të njëjtës reklamë dhe në disa blloqe reklamuese është vërejtur një paraqitje e ndryshme e reklamave të transmetuara në Shkup dhe në Gostivar. Ai theksoi se pjesa folëse e programit ishte identike si në Shkup dhe Gostivar. Duke pasur parasysh se shërbimi programor në pajtim me Ligjin është një grup programesh dhe elementësh të tjerë ndërsa elementët e tjerë janë blloqet reklamuese, radiodifuzeri praktikisht transmetonte dy shërbime të ndryshme programore dhe atë në disa raste gjatë ditës dhe natës. Ajo deklaroi se në Raport ka një pasqyrë të detajuar të të gjitha blloqeve të reklamave nga ora 5 e mëngjesit të çdo ore të shfaqur deri në 10 të mbrëmjes. Aty theksohet se kjo nuk është analiza e parë e tillë e RA Kanal 77. Agjencia ka pasur analiza dhe reagime të tilla para hyrjes në fuqi të këtij ligji nga viti 2014, ndërsa reagimi i fundit i Agjencisë sipas këtij ligji ka qenë vitin e kaluar më 30 qershor dhe Agjencia i ka dërguar shkresë (letër) transmetuesit që menjëherë të rregullojë programin. Atëherë ka pasur peticione nga transmetuesit nga Koçani dhe Kumanova. Është bërë monitorim, është bërë krahasimi i programit dhe është konstatuar se në të tri zonat e Shkupit, Kumanovës dhe Koçanit janë transmetuar blloqe të ndryshme reklamuese dhe dallimet janë mbuluar me muzikë. Dhe atëherë si tani pjesa e të folurit ishte identike. Për këto arsye, duke marrë parasysh konstatimet, pra se transmetuesi nuk ofron transmetim të një shërbimi të vetëm programor në tërësi të programeve dhe elementeve të tjerë të një shërbimi të vetëm audio mediatik që është destinuar për praninë nga publiku në të gjithë territorin e shtetit, i cili është në kundërshtim me nenin 68 të LSHMAAV dhe gjithashtu me nenin 3 të LSHMAAV, në Raport propozohet që Drejtori i Agjencisë t'i paraqesë propozim Këshillit për ngritjen e procedurës për marrjen e lejes sepse pas dhënies së lejes u krijuan rrethana që paraqesin pengesa ligjore për zotëruesin e lejes për kryerjen e veprimtarisë, respektivisht zotëruesi i lejes nuk siguron transmetimin e një shërbimi të vetëm programor të transmetuar në tërësi të programeve dhe elementëve të tjerë të një shërbimi të vetëm audio mediatik në zonën për të cilën është dhënë leja në të gjithë territorin e shtetit.

Z. Petrushevski tha se ky propozim është mjaft serioz dhe kërkoi mendimin e anëtarëve të Këshillit. Ai shpjegoi se transmetuesi disa herë e shkel të njëjtin nen të Ligjit. Vitin e kaluar në qershor kishte një sjellje të ngjashme, i është vënë në dukje dhe duke qenë se përsëritet, sot propozimi për masë ka më shumë peshë, respektivisht të fillohet procedura për heqjen e lejes. Kjo nuk do të thotë se leja për transmetim në radio do t'i hiqet dhe nuk është ky qëllimi, por synimi është që të punojë në përputhje me ligjin, në të gjithë territorin për të cilin posedon lejen të transmeton program të njëjtë që përfshin edhe reklamat.

Z. Trajçev tha se materialin e ka shqyrtuar pikë për pikë dhe mendimi i tij personal lidhur me gjithë situatën në tërësi është se në esencë të programit, reklamat disi nuk hyjnë në programin bazë dhe sipas tij nuk duhet të ketë ndonjë problem në lidhje me këtë që programi të jetë identik, por reklamat të jenë të ndryshme nga aspekti i nevojës ekonomike të transmetuesve, aq më tepër që për reklamat ka synim audienca. Por nga ana tjetër, nga aspekti formal po ta shikosh Ligjin, në atë pjesë është i qartë. Këtë e thotë më shumë se si ai mendon, por sigurisht që Këshilli duhet të punojë sipas ligjit. Më tej, mund të iniciohen disa ndryshime legjislative që do të lejojnë që reklamat të mos jenë pjesë e një programi, të ekziston mundësia që transmetuesit në rajone të ndryshme të kenë reklama të ndryshme sepse kanë audiencë me synime të ndryshme sepse disa reklamues, duke pasur parasysh natyrën e vendit, bëjnë nuk kanë nevojë të reklamohen në vende apo rajone ku nuk janë të pranishëm. Kjo mbase në një farë mënyre mund t'ua lehtësojë punën dhe nuk e sheh se është problem thelbësor në raport me programin që po transmetohet sipas shikuesve. Nga ana tjetër nga aspekti formal, ekziston neni 3 paragrafi (1) pika 12 nga LSHMAAV ku thuhet qartë se një shërbim programor, një kanal programor është një grup programesh dhe elementësh të tjerë, ku theksohet - në një shërbim të vetëm mediatik audio ose audiovizual që ofron një transmetues i caktuar dhe që synohet të pranohet nga ana e publikut, dhe neni 68 nga LSHMAAV ku thuhet në lidhje për të drejtat. Nga ky aspekt, nëse ligji shihet dhe lexohet, dhe detyra e Këshillit është të veprojë sipas ligjit, do të jetë i obliguar të mbështesë propozimin që i është dhënë Këshillit nga Shërbimi Profesional, në mënyrë që nëse më tej bëhen ndryshime ligjore, mbase në të ardhmen kjo do të lejohej sepse ai personalisht nuk sheh pengesa dhe shkak dhe asnjë shkelje të programit në tërësi, dhe të lejojë që reklamat të jenë ndryshe. Por në këtë rast tani Ligji ashtu siç është vendosur, janë të detyruar të veprojnë sipas tij.

Z. Fidanoski tha se e ka dëgjuar me kujdes udhëheqësen Janevska, e ka lexuar dhe materialin në detaje sepse bëhet fjalë për çështje delikate. Ai beson se pasi janë në këtë përbërje të Këshillit, për herë të parë kanë një pikë të tillë, për një çështje të tillë të ngrihet iniciativë për heqjen e lejes të një transmetuesi, edhe pse u përmend se edhe vitin e kaluar ka pasur shkresa, dhe para kësaj ka pasur indikacione për ndryshimin e mënyrës së transmetimit të këtij programi. Supozimi i tij është se kjo mënyrë e ndarjes së reklamave sipas rajoneve ekziston prej kohësh, duke pasur parasysh se nga ana e transmetuesit është e saktë. Ndoshta ai, ashtu si z. Trajçev, beson se reklamë e ndryshme nuk e cenon skemën e programit që transmetohet nga radiodifuzeri, megjithatë, Ligji në këtë moment ashtu siç është në nenin 3 paragrafi (1) pika 12 për veçantinë e shërbimit programor, RA Kanal 77 është radio e folur-muzikore, thotë se "shërbimi programor ose kanali programor është tërësi programesh dhe elementësh të tjerë të një shërbimi të vetëm mediatik audio ose audiovizual të ofruar nga një transmetues i caktuar dhe i destinuar për t'u marrë nga publiku. Dhe tani ndoshta për dikë supozimi i tij, që do të thotë "dhe elemente të tjera" nuk është cekur detajisht se ato përfshijnë komunikime komerciale dhe reklama, kështu që për këtë arsye udhëhiqen nga logjika, çdo gjë që nuk është e ndaluar me ligj është e lejuar dhe ne mund ta përdorim. Sipas tij, ato elemente të tjera përfshijnë reklamat, xhinglat, detyrimin për të shprehur impresium (një përshtypje). Nëse diku ato blloqe shërbimi ishin më të shkurtra siç thuhet në materialet e një rajoni në krahasim me tjetrin, ai boshllëk kohor ishte plotësuar me muzikë, por kjo tashmë është një ndryshim dhe në skemën muzikore të formatit të asaj radioje, që do të thotë se në një moment aty vërshojnë ndërsa atje luan (shkon) muzikë pavarësisht nëse zgjat 5 sekonda, 35 apo më shumë për të barazuar kohën deri në fillimin e pjesës me fjalë të programit. Udhëheqësja Janevska ka shpjeguar bukur dhe ka shënjestruar disa nene ligjore që tregojnë se tashmë janë bërë shkelje të mundshme, dhe Këshilli duhet të iniciojë procedurë për heqjen e lejes dhe supozon se transmetuesit duhet t'i jepet afat për të harmonizuar programin e tij si i vetmi në gjithë territorin e shtetit. Për këto arsye, ajo mendon se do të duhej të përcaktohet saktësisht se sa do të ishte ajo periudhë për të harmonizuar programin në pajtim me lejen. Ajo tha se gjatë përgatitjes për këtë seancë, për të pasur një pasqyrë sa më të plotë të këtij rasti konkret, ka hasur në njohuri që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me këtë transmetues, se disa transmetues lokal, shtrirja e sinjalit të tyre e kalon kufirin për të cilën i është dhënë leja. Lidhur me këtë, ajo tha se do të dëshironte kjo të kontrollohet nëse është ashtu dhe nëse është ashtu, ata transmetues do të duhet të zvogëlojnë transmetuesit e tyre amplifikatorët që të përputhen me sinjalin.

Z. Trajçevski sqaroi se ASHMA-ja nuk mund ta bëjë këtë, por nëse ka njohuri është mirë të njoftojë dhe të kërkojë nga Agjencia për komunikime elektronike kudo që ka njohuri të bëjë matje dhe nëse është kështu, siç thuhet të ndërmerren masa që ata transmetues të harmonizojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me lejen e dhënë nga ASHMA-ja për zonën ku mund të transmetojnë program në nivel lokal. Sa i përket çështjes së afatit për respektim, ai ka shpjeguar se Këshilli do të fillojë procedurën për heqjen e lejes, dhe ai afat është i përcaktuar me ligj dhe është 15 ditë nga dita e dorëzimit të propozimit. Në këtë kuptim, afati sipas ligjit është 18 tetori. Në mënyrë që Këshilli të marrë vendim, duhet të bëhet sërish regjistrimi i frekuencave ku transmetohet ky shërbim programor, më pas të bëhet analizë krahasuese nëse në ato frekuenca të ndryshme transmetohet i njëjti apo program tjetër dhe më pas Këshilli do të marrë vendim. Në varësi të aktiviteteve, Këshilli do të informohet menjëherë për datën kur do të mbahet seanca.

Z. Fidanoski, lidhur me diskutimin e tij për shtrirjen e sinjalit të disa transmetuesve vendor, tha se nuk pretendon, por se ka arritur deri në njohuri të tillë dhe i ka shprehur. Kërkon të kontrollohet dhe nëse ka mundësi të bëhet matje, por nuk pretendon se është 100% kështu. Sa i përket afatit, ai tha se pajtohet që transmetuesi të marrë afat konkret që do të jetë i mjaftueshëm për të harmonizuar programin.

Z. Petrushevski sqaroi se sot Këshilli nuk merr vendim me të cilin i hiqet leja, por konkluzion për fillimin e procedurës, me afate për respektim që i tha drejtori dhe që janë në përputhje me ligjin. Sipas tij, transmetuesi do të ketë kohë të mjaftueshme për të respektuar.

Z. Ajdini tha se sa herë që në rend dite ka iniciativë për fillimin e procedurës për heqjen e lejes, ai si anëtar i Këshillit nuk ndihet rehat. Por tani situata është e qartë, transmetuesi ka shkelur Ligjin dhe seanca duhet të përcjellë mesazh se Ligji duhet të respektohet sepse ashtu siç theksoi z. Fidanoski, në të ardhmen mund që edhe transmetues të tjerë të bëjnë të njëjtën. Agjencia dhe Këshilli nuk duhet të jenë selektivë por duhet të dërgojnë mesazh të qartë se Ligji duhet respektuar. Ai beson se në ndërkohë transmetuesi do të arrijë të harmonizojë programin e tij dhe Këshilli nuk do të jetë në situatë që të marrë lejen.

Z. Jançeski tha se tani shtrohet pyetja nëse ky është i vetmi transmetues që kryen këtë lloj shkeljeje. Shtroi pyetjen drejtuar shërbimit profesional nëse gjatë mbikëqyrjes së rregullt bëhet skanim apo analizë e punës së transmetuesve tjerë për këtë lloj kundërvajtjeje?

Z. Trajçevski sqaroi se në hapësirat e Agjencisë është e mundur të regjistrohen vetëm programet e radiostacioneve kombëtare dhe rajonale nga Shkupi. Për të gjithë të tjerët, Agjencia nuk ka pajisje dhe duhet të shkosh në terren në qytete të tjera për të kryer regjistrimin. Njohuritë që ka Agjencia janë se asnjë transmetues, as radio dhe as televizion, nuk e aplikon këtë metodë të punës dhe deri më tani nuk ka pasur ankesa për asnjë transmetues përveç RA Kanal 77. Vitin e kaluar është konstatuar e njëjta situatë, por shkelja u mënjanua. Pas një kohe të caktuar, duke menduar se Agjencia nuk do të bëjë më mbikëqyrje, ky transmetues vazhdoi me të njëjtën praktikë të funksionimit. Agjencia ka pasur njohuri edhe më herët se çfarë është deklaruar në takimin publikë se transmetuesi nuk respekton Ligjin që përcakton se shërbimi programor që transmeton duhet të jetë identik në të gjitha frekuencat për të cilat ka marrë leje nga AKE.

Z. Petrushevski sqaroi se të dyja mbikëqyrjet janë bërë pas ankesave, e para pas ankesës me shkrim dhe e dyta është thënë në takim publike.

Udhëheqësja Janevska, në lidhje me dilemën e z. Fidanovski se ndoshta transmetuesi nuk e ka pasur të qartë se cilat janë segmentet tjera programore, përkujtoi se Agjencia ka miratuar Udhëzues për mënyrën e klasifikimit të llojeve të programeve mediatike audio dhe audiovizuele, ku është deklaruar saktësisht se cilat përmbajtje konsiderohen si segmente të tjera të programit dhe ka ofruar përkufizime siç janë dhënë për llojet e programeve. Gjithashtu, dhe vetë formulari për dhënie të lejes është i strukturuar në atë mënyrë që tabela ndan qartë se cilat lloje programesh përfshihen në llogaritjen e formatit dhe cilat janë segmentet e tjera të programit. E gjithë kjo është paraqitur shumë qartë në tabelë dhe të gjithë transmetuesit kanë kaluar në procesin e plotësimit

të këtij formulari për marrjen e lejes. Në këtë drejtim, ai tha se të gjithë transmetuesit e dinë shumë mirë se çfarë përfaqësojnë "elementet e tjera programore".

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka inicuar procedurë për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Radio KANAL 77 SHPKNJP Shtip, për shkak të shkeljes së nenit 68, në lidhje me nenin 3 paragrafi (1) pika 12 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19) dhe (Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr.42/20, 77/21 dhe 154/23).

Sipas Raportit me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të jashtëzakonshme programore sipas detyrës zyrtare, nr.10-3676/1, datë 5.10.2023, më 6 shtator 2023, zotëruesi i lejes nuk ka siguruar transmetimin e një/vetëm shërbimi programor të transmetuar në tërësi nga programe dhe elemente të tjera të një shërbimi të vetëm audio mediatik që është i destinuar për pranimit nga publiku në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut .

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk harmonizon menjëherë punën e tij me LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do të miraton Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Radio KANAL 77 SHPKNJP, PA1 nr.08-64, datë 5.01.2015, vazhduar me Vendimin PA1 nr.08-258, datë 15.8.2023.

Pas votimit, z. Petrushevski tha se në ditët kur do të njoftohet transmetuesi duhet t'i thuhet dhe nëse është e nevojshme me telefon dhe të shprespjëm që në 10 ditët e ardhshme, kur do të bëhet kontrolli, se gjithçka do të jetë në rregull.

Z. Trajçevski proceduralisht, duke pasur parasysh se z. Jançeski ka njoftuar se ka obligime urgjente në orën 15:00, propozoi që nëse Këshilli pajtohet, në seancë të shqyrtohet edhe një pikë nga Rendi i ditës dhe pjesa tjetër të shtyhet për vazhdim të seancës.

Z. Petrushevski pranoi që seanca të ndërpritet pas shqyrtimit të pikës 4.

Pika 4

Z. Trajçevski shpjegoi Propozim-vendimin për vazhdimin e afatit për fillimin e veprimtarisë së Institucionit Radiodifuziv Jofitimprurës UNIVERZUM Shkup. Ai ka shpjeguar se ky subjekt ka marrë vendim nga Këshilli për dhënien e frekuencës për lejen e transmetimit të programit në radio në territorin e rajonit të Shkupit për radio jofitimprurëse dhe është dashur të fillojë punën më 3 tetor të javës së kaluar. Por vendimin për kompaninë e themeluar e ka dorëzuar në Agjenci në fund të orarit të punës më 3 tetor. Në të njëjtën kohë, Agjencia nuk ka mundur të japë leje pa atë dokument dhe ai nuk ka mundur të fillojë me punë pa pasur leje nga Agjencia. Për këtë arsye është kërkuar që me ligj t'i zgjatet afati, që Agjencia t'i japë leje dhe të fillojë transmetimin e programit nga data 10 tetor. Ai ka shpjeguar se praktikë të tillë dhënie të afateve të reja për vazhdimin e fillimit të punës, Agjencia tashmë ka pasur. Mendimi i tij personal është se ky kandidat që ka marrë leje ka mundur të jetë pak më i përditësuar dhe të mos priste ditën e fundit kur duhet të bëhet regjistrimi në Regjistrin Qendror.

Këshilli i Agjencisë me 5 vota "pro" dhe një votë abstenim nga z.Trajçev miratoi vendim për vazhdimin e afatit për fillimin e kryerjes së veprimtarisë për transmetim në radio të shërbimit programor për popullatën studentore, në gjuhën maqedonase, në nivel rajonal të Shkupit për Institucionin Radiodifuziv Jofitimprurës UNIVERZUM Shkup, themeluar nga personi juridik Institucioni i Arsimit të Lartë Privat Universitar Shkup - Shkup, me tekst siç është propozuar Vendimi.

Institucioni radiodifuziv jofitimprurës UNIVERZUM Shkup duhet të fillojë me kryerje të veprimtarisë më së voni deri më 10.10. 2023.

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshilli duhet ta publikojnë vendimin e mësipërm në “Gazetën Zyrtare të RMV-së” dhe në ueb-faqen e Agjencisë.

Pas votimit, z. Petrushevski e ndërpreu seancën dhe e shtyu për fillimin e seancës së ardhshme.

Nr. 02-3637/12

16.10.2023

Shkup

Agjencia për Shërbime Mediatike

Audio dhe Audiovizuale

Kryetari i Këshillit,

Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.